



Shqip



Drejtor BESNIK MYFTARI
Kryeredaktor ALFRED PEZA
Zv/Kryeredaktor URIM BAJRAMI

Viti I - Nr. 243 E diei, 12 nëntor 2006 E përditshme e pavarur Çmimi 30 lekë, 1.5 euro

Adresa e redaksisë:
Bulevardi "Zogu I Parë",
Pallati 13-katësh, Ap. 3
Tel: 04 272 565 • 068(9) 20 35 300
E-mail: info@gazeta-shqip.com
www.gazeta-shqip.com

Problemet: Janë ndryshuar elementët e sigurisë dhe cilësia e letrës. Përgjegjëse: Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Certifikatat, abuzim me tenderin

Raporti i KLSH zbulon tri shkeljet: "Firma fituese ishte e paracaktuar"

Pavarësia është e sigurt. Por çfarë pavarësie?

MUSTAFA NANO

Vendimi i kryenegociatorit të OKB-së mbi çështjen e Kosovës, Marti Ahtisaarit, për ta shtyrë në vitin e ardhshëm përcaktimin e statusit final të Kosovës, edhe pse ka provokuar një zhgënjim të atypëratyshëm ndër shqiptarët, në të vërtetë nuk përbën ndonjë lajm apriori të trishtuar. Sigurisht, shqiptarët e Kosovës janë tanimë të lodhur me këtë gjendje "as mish, as peshk", në të cilën ata ndihen disi të përqeshur prej faktit, që edhe kanë të drejtën për të prodhuar nëpërmjet zgjedhjes organe...

NE FAQEN 11

"TIME", 1945

Enveri, brutali me fytyrë engjëjllore

Ndërsa Shqipëria sapo kishte dalë nga lufta, ko munistët ishin në hapat e tyre të parë për konsolidimin e pushtetit, frenat e të cilit akoma nuk i kishin marrë plotësisht në dorë. Qysh prej një muaji e gjysmë, qeveria e kryesuar nga një Kryeministër komunist, duket se po përpjehet të ngjante sa më demokratike në synime e pretendime përballë fuqive perëndimore, të cilat, siç theksoan edhe shtypi amerikan i kohës, ishin me një prezencë të vogël në atë vend, por që gjithsesi shumë në prezencë se sa rusët. Në tri artikuj relativisht të shkurtër të revistës amerikane "Time"...

NE FAQET 26-27



Një nga protestat e ish-ushtarakëve

"Katër shkeljet për pensionet e ushtarakëve"

NE FAQEN 34

Raporti më i fundit i KLSH-së ka zbuluar shkelje ligjore në procesin e tenderimit dhe të prodhimit të certifikatave. Sipas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, firma, e cila prodhoi certifikatat ishte e paracaktuar të fitonte, ndërsa dy firmat e tjera janë skualifikuar në mënyrë joligjore nga ana e komisionit dhe vlerësim-it të ofertave. Në këtë mënyrë është ngritur sërish problemi i elementeve të sigurisë së certifikatave në prag të zgjedhjeve vendore. Raporti i marrë nga Kontrolli i Lartë të Shtetit, tregon tri shkeljet që janë vërejtur në certifikatat, që aktualisht përdoren nga qytetarët. Shkelja e parë lidhet me procesin e tenderimit, mënyrën se si është zhvilluar dhe se si është shpallur fituesi. E dyta, lidhet me hartimin e modelit të certifikatave. Firma, e cila ka fituar tenderin, ka ndryshuar elementët e sigurisë, detyrë kjo e cila është...

FAQEN 2

Fati i 1700 dosjeve të bartura nga ish-Komiteti i Pronave dhe 1 tetori 2007, afati i fundi për gjithë të shpronësuarit

Pronat, kompensim vetëm për 200 m2

Zv/drejtoresha e Agjencisë, Elga Vukaj, shpjegon vendimin e ri të qeverisë

NE FAQEN 5

Djali 11-vjeçar i Leodat Kirit shpëton mrekullisht Atentat me eksploziv drejtorit të Shërbimeve Funerale

NE FAQEN 6



Leonora Rama

I biri i 47-vjeçares i kishte vrazë vëllain në Spanjë Në Vlorë, 16-vjeçari vret për hakmarrje oficeren e marinës

NE FAQEN 7

Drejt Italisë, gomone me 150 kg drogë

Ringjallet trafiku i drogës, që transportohet me gomone në drejtim të brigjeve italiane. Një mjet lundrues është kapur nga Guardia di Finanza, pasi në bordin e saj janë zbuluar plot 150 kilogramë marijuanë, ndërkohë disa orë më pas policia italiane ka vënë në pranga edhe skafistin Ardian Lamaj...

NE FAQEN 13



NE FAQET 36-37

HISTORI

KOLOS I DYRRAHUT

ARTAN SHKRELI

Dyrrahu ishte ndër qytetet kolosale të Antikitetit.

Gjithnjë empor kryesor në Hadriatik, deri në kohë të vona romake, kjo qendër la gjurmë të pashlyeshme në qyteterimin e mëtejshëm të gadishullit famëmadh të qafjtur Ballkan. Treve pellazge e mbretit prehistorik Epidamn, qytet ilir i mbretit Dyr-rah, koloni helene e Korkyrasve dhe metropol pas mundjes së Teutes nga romakët, mu pikërisht në zenit të madhësisë së tij, ai do të linte njëherë ndër gjurmët arkitekturore me kolosale të Ballkanit të lashtë: Amfiteatrin e Madh të Dyrrahut. Gëzoi famën e përbotshme si qytet liberal (sikundër të gjitha metropolet e botës antike e moderne) dhe përbotshtë ciklin e tij jetësor, herë nën tërmetet e lahtarshme që e goditën, e herë nën luftërat shkatërruese, duke u zvogëluar...

NE FAQET 22-23

Futboll
SUPERIORJA
Shkumbini dhe Flamurtari, çfarë surprize!
NE FAQET 44-45

REAL & ÇELSI
Tronditen pankinat e gjigandëve
NE FAQEN 47


Albtelecom
20 Lekë/min*
Itali Greqi USA Kanada
* E vlefshme për abonentët familjarë nga ora 13:00-16:00 dhe 21:00-07:00. Itali e Greqi, për telefonat celularë 37.5 Lekë/min. Tarifat janë pa TVSH.

CAPITAL
INSTITUTI PRIVAT I PENSIONEVE
Rr: "Dervish Hima", Nr. 2/1, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 348 000
Tel/Fax: +355 4 363 003
E-mail: contact@capital.com.al
Web: http://www.capital.com.al

VARTA
Bushi Sh.p.k. Distributor Ekskluziv për Shqipërinë
Adresa: Rr.Durrësit "Pallatet Hawai", Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 266400 / +355 4 267773
Fax: +355 4 234115
E-mail: bushi@albaniaonline.net


LEKSIONET
Trashëgimia shqiptare udhëton nëpër SHIBA
Auron Tare ka prezantuar në Universitetin e Çikagos modelin shqiptar të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Butirrit dhe Gjrokastra, si mundësi e zhvillimit ekonomik dhe kulturor
NE FAQET 40-41

Intervistë ekskluzive për gazetën "Shqip" e shqiptaro-amerikanit Gjek Marinaj, me origjinë nga Malësia e Madhe, i cili që prej vitit 1990 jeton e punon në Dallas të SHBA-së. Si arriti ai të hiqte nga tekstet mësimore të "Richland College", ku jep mësim, shkrintarin më të madh amerikan të të gjithë kohërave, Nathaniel Hawthorne dhe në vend të tij të fuste shkrintarin tonë Ismail Kadare



DASHNOR KALOÇI

Ashtu sikurse dihet tashmë, fama e shkrintarit tonë të madh Ismail Kadare, prej disa dekadash i ka kaluar kufijtë e Shqipërisë dhe ai është bërë i njohur edhe në shumë vende të botës, ku janë botuar dhe ribotuar pjesa më e madhe e veprave të tij. Madje jo vetëm kaq, por disa nga librat e tij më të spikatur në gjuhën e prozës kanë fituar të drejtën të studiohen edhe në tekstet e programeve mësimore të kolegjeve të ndryshme të këtyre shteteve. Një nga ato shkolla ku studiohet vepra e Kadaresë është "Richland College" në Dallas të Teksasit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku prej disa vitesh nxënësit e tij në lëndën e letërsisë botërore kanë të programuar librin "Ura me tri harqe", të cilin shkrintari ynë i famshëm e ka shkruar në fillimin e viteve '70-të. Po si është bërë e mundur që kjo veper e Kadaresë të studiohet në atë kolegj? Lidhur me këtë, dëshmon për herë të parë, ekskluzivisht për gazetën "Shqip", shqiptaro-amerikanin Gjek Marinaj (me origjinë nga Malësia e Madhe, prej vitit 1990 jeton e punon në SHBA), i cili është dhe pedagogu i atij institucioni arsimor, ku arriti ta realizonte këtë gjë.



Zoti Marinaj, si ju lindi ideja dhe pse vendosët që të fusnit në programet mësimore të kolegjit librat e Kadaresë? Si u prit kjo gjë nga titullarët e atij institucioni arsimor ku ju jeni pedagog?

Ideja nuk ka qenë e formuar plotësisht në faktin se Kadareja është një shkrintar shqiptar. Ai ofron një fuqi të rëndësishme në gravitetin e së bukurës në letërsisë e sotme botërore. Kjo nuk do të thotë se nuk jam ndikuar prej njohjes nga afër me krijimtarinë e tij. Megjithatë, ideja për futjen e Kadaresë në programin mësimor të kolegjit nuk ka qenë një produkt i nostalgjisë, por i këmbënguljes time profesionale për t'u afruar studentëve oportunitetet më të përshtatshme për suksesin e tyre shkollor. Idetë për të realizuar diçka gjithmonë duhet të jenë në balance me qëllimin e finalizimit të tyre. Në rastin tim, qëllimi ka qenë konkret. Në njërin anë, edhe sikur letërsia e Kadaresë të rrezatojë për studentët e mi vetëm një fraksion të efektit të kenazhës dhe argëtimin letrar që përjetoj unë, ato do të ngjeshim më së të kënaqur me vendimin tim. Nga ana tjetër, dhe më të rëndësishmja, duke u dhënë studentëve oportunitetin të studiojnë një shkrintar të kalibrit Kadare, unë i ftoj të hyjnë në një univers krejt të ri letrar për ta. Aty u jepet mundësia të shijojnë reflektimin e një ylberi të çuditshëm letro-artistik, ku larmia e ngjyrave të dritës që gjenden aty ka nocione homeriane, në kuptimin e hapësirës së imagjinatës dhe një thellësi virgilliane në aspektin e aplikimit të fuqisë së mendimit artistik në prozë. Se bashku ato i bashkëngjijën një kompozim sipas mësimorëve që nxjerrin nga pena e Dantes. Pra, letërsia Kadareane ishte një "manual" më i kompletuar se ai që ata studiojnë më parë për të njëjtën klasë.

Megjë e përjetonit një ndjenjë kaq të fortë për librat e Kadaresë, pse e realizuat kaq vonë futjen e tij në programet e kolegjit ju jeni mësimor?

Mungesa e eksperiencës ka luajtur rolin e saj në këtë proces. Vitin e parë të mësimdhënies e kam kaluar si "duke ecur mbi vezë", duke zbatuar me konkretësi dhe duke konsideruar gati çdo sugjerim të kolegjeve, pa u përqendruar shumë në idetë e mia, apo në opsionet që kisha për të ndihmuar në mënyrë sa më efektive studentët. Mendimi se studentët amerikanë kanë nevojë për letërsinë e Kadaresë, më është vërtetuar në vetëdije për një kohë të gjatë. Nxënësit për të marrë kontroll të plotë pedagogjik, për fat të mirë nuk më zgjati shumë. Me njohjen se "kush është kush" në bordin drejtues të kolegjit, fillova të "nxjerr krye" dhe të shpreh mendimet e mia se çfarë është e nevojshme për stilin tim të mësimdhënies dhe për studentët e mi. Midis të tjerash, kërkova ndryshimin e teksteve të detyruara suplementare për seksionin e letërsisë botërore të lëndës

"Si e futa Kadarenë në programet mësimore të kolegjit të Dallasit"

"English and Communication" që jepja. Në fillim insistova në zëvendësimin e librit "The old man and the sea" (Plaku dhe deti) të nobelistit amerikan Ernest Hemingway, me librin "The bluest eye" (Syri më i kaltër) të nobelistes tjetër amerikane, Tony Morrison. Më vonë, pasi e ndjeva se vendi im i punës ishte i sigurt, pavarësisht nga natyra e kërkesave që parashtrija, bëra kërkesën për zëvendësimin e librit të dytë "The scarlet letter" (Germa e kuqe) të shkrintarit amerikan Nathaniel Hawthorne me librin "The concert" (Koncert në fund të dimrit) të Ismail Kadaresë.

Dhe cila ishte përgjigja që morët?

Pas një kohe, për zhgënjimin tim u aprovua vetëm ndryshimi për librin e parë. Ndërsa për librin e Kadaresë mora një përgjigje të shkurtër, të ftohtë negative, ku thuhet: "Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj për zëvendësimin e librit "The scarlet letter", të Nathaniel Hawthorne, me librin "The concert" të Ismail Kadaresë, ju njoftojmë me keqardhje se kërkesa juaj nuk është aprovuar. Klasa juaj ka në program vetëm dy libra suplementarë dhe ne mendojmë se libri i parë është më i përshtatshëm se i dyti për programin tonë".

Cila ishte lëvizja juaj e dytë, apo plani B, në se mund të themi kështu?

Edja se refuzimi i kërkesës time kishte të bënte me një problem sipërfaqësor, që shpallte paralellisht me një çështje më të thellë. Problemi i parë ishte tematika dhe mësimet konstruktive që mund të nxirrnin studentët nga zhvillimi i ngjarjeve të trajtuara. Kjo nuk më befasoni, për vetë faktin se njëri libër trajtonet standardet morale dhe konsekuencat e tyrejes së tyre në Bostonin e një të kaluar relativisht të lashtë, kurse tjetri kishte të bënte me marrëdhëniet shqiptaro-kineze të dekadave të fundit të shekullit që kaloi. Thelbi i hezitimit të tyre, mendoj unë. Ishte edhe njohja e plotë e vlerave artistike të Nathaniel Hawthorne, i cili është i njohur si njëri nga shkrintarët më të mëdhenj amerikanit të gjitha kohërave, përball njohjes së kufizuar e aftësive letrare të shkrintarit shqiptar që bëhej fjalë ta zëvendësonte atë. Kështu, rezervova një kohë të përshtatshme me drejtorin e departamentit të gjuhës dhe letërsisë angleze të kolegjit, pro-



fesor Ed H. Garcia. Pas takimit të planifikuar për 30 minuta, i cili zgjati gati 2 orë, u bë i mundur miratimi, por për një libër tjetër të Kadaresë, atë të titulluar "The three arched bridge" (Ura me tri harqe).

Cila ishte strategjia juaj që bëri të mundur të thyenit barrierën e kundërshtimit, dhe pse "Ura me tri harqe"?

Në fillim i shpjgova se është në interesin e studentëve të mi që ata të ekspozohen të një larmi teknikash dhe burimesh akademike që mundësojnë kalimin e formave e teksteve letrare nga kultura e huaja për të kultura jonë (amerikane). Në të njëjtën kohë, i parashtrora mendimin se është e rëndësishme që studentëve t'u jepet mundësia e një përfutje më të madh drejt thesarëve të letërsisë së Ballkanit dhe të krejt Evropës Lindore. Këtë e lidha me idenë së letërsia e Kadaresë dhe metodologjitë e gjetura në artin e prozës e tij të përkthyer në anglisht, mund të kontribuojnë ndjeshëm në ndihmë të studentëve, vecanërisht në revitalizimin e aktit të interpretimit dhe të promovimit të studimeve të disiplinave të artit dhe humanizmit. Pra u mundova të argumentoj se studentët tanë kishin më shumë nevojë për letërsinë e Kadaresë, se për atë të shkrintarit Nathaniel Hawthorne. Disa nga pikat shtesë të argumentit konsistonin me nevojën e mësimin të metodave se si letërsia e përkthyer mund të aplikohet tek interpretimet e saktë të tekstit letrar dhe të humanizmit në përgjithësi. Po kështu, gjatë njohjes me letërsinë e shkrintarit shqiptar, studentët do të mësonin se si komunikimet ndërkullore dhe negoci-

atat shoqërore mund të implimentohen me sukses në prozë. Gjë që studentëve nuk ua ofronte dot letërsia e Hawthorne-it, ashtu siç nuk ofronte as prezantimin e tyre me skenën bashkohore të letërsisë së huaj. E mbi të gjitha, thashë unë, duhet analizuar fakti se Kadareja ishte edhe poet i kalibrit botëror, dhe se proza e tij ishte e fuqizuar me intonacione poetike, gjë që vet Hawthorne e ka pranuar se mungon në prozën e tij.

Si e pritë profesor Garcia idenë tuaj se Kadareja është shkrintar më i nevojshëm për studentët amerikanë se Hawthorne?



Në fillim me skepticizëm. Por e klasifikova mendimin nën fjalën kyçe "nevojë" e studentëve dhe shpjgova se nuk bëhej fjalë për krahasim madhështie midis shkrintarëve në fjalë. Një tentativë e tillë ju vetëm që nuk është në akord me gjykimin tim për letërsinë, por në të njëjtën kohë do të ishte diçka krejtësisht absurde. Në e dinim se Hawthorne dhe Kadareja janë dy të ishte ndryshe në njëherësh të njëjtën botë letrare në mënyrë unike dhe të pavarur nga koncepti krahasues. Krahasimet cilësore nuk kishin vend në bisedën tonë, faktet po të gjitha ato që ia përmenda atij dhe dy profesorëve të tjerë që gjendeshin aty, ishin vetëm disa arsye që të shtynin të mendoje se letërsia e Kadaresë do të ishte më e bënin vetëm me origjinën kullore dhe pikën geografike të vendndjes së autorëve. Madje edhe kur fola për faktorin poezi, si një avantazh në prozën e Kadaresë, kuptohet se edhe Hawthorne e kishte një të veçantë dominues ndaj kre-

jt letërsinë perëndimore në prozën e tij: filozofinë. Faktikisht, Kadareja dhe Hawthorne kanë ngjashmëri në librat e tyre. Siç e thashë edhe më lart, ishte detyra ime t'i bindja profesor Garcia-në dhe dy profesorëve të tjerë, që ai kishte ftuar të merrnin pjesë në këtë takim, Hillary Fleming (profesoreshë e letërsisë botërore) dhe Mike Garza (profesor i psikologjisë), se nëse studentët do të humbin diçka nga largimi prej njëri libër, në të njëjtën kohë do të fitonin diçka nga studimi i librit tjetër. Aq më tepër kur propozimi im i fundit ishte "Ura me tri harqe", kundrejt librit "Germa e kuqe". Të dy librat kishin linja të caktuara që bashkoheshin në të njëjtën pikë të trajtimit të skenave. Midis të tjerash nxora konkluzione se të dy librat përqendroheshin në lidhjet e traditës fetare (të kohëve e tyre respektive) me mëkatin dhe diturinë njerëzore. Të dy librat i japin një rëndësi të veçantë aspektit social dhe perspektive për ta jetuar ata në akord me parametrat e orkestruar nga grupe me interesa të caktuara në shoqëritë përkatëse. Në një nivel tjetër kemi të bëjmë me disa veçori psikologjike, të ngjashme me të dy librat, të identitetit dhe jetës personale të personazheve. Në të dy librat duhej të murosej nga një jetë që të tjerët të gjenin sado-fiksion dhe qetësi mendore në jetën e tyre, ndonëse njëri murim bëhet në trupin guror të një ure dhe tjetri në trupin antisocial të një shoqërie hipokrite...

Si reagonin profesorët gjatë argumenteve që u parashtrorit ju, çfarë përfytyrë të kanë bërë më shumë përshytyrje?

Përfytyrë që bënin, me kalimin e kohës morën natyrën e një bisede shoqërore. Në fillim duke i interesit i tyre se do e bëja transformimin e ideve që kisha nga funksionit teorik në atë praktik. Dhe se si do të ndikonte ky transformim në jetën akademike dhe sociale të studentëve. Megjithatë, kur filluam të bisedonim më lirshëm, u deshtë të trogesha më i kujdesur në përgjigjet e mia. Them kështu se natyra e pyetjeve delngadega po merre dimensione të tjera konverionale. Një nga pyetje që më bëri më shumë përshytyrje erdhjo nga profesor Garcia, apo nga profesor Fleming, por nga profesori i psikologjisë, Mike Garza. Ai më pyeti se nëse do më duhej ta përkufizoja në një

Ishin vetëm disa arsye që të shtynin të mendoje se letërsia e Kadaresë do të ishte më e nevojshme për studentët dhe kishin të bënin vetëm me origjinën kulturore dhe pikën gjeografike të vendlindjes së autorëve. Madje edhe kur fola për faktorin poezi, si një avantazh në prozën e Kadaresë, kuptohej se edhe Hawthorne e kishte një të veçantë dominuese ndaj krejt letërsinë perëndimore në prozën e tij: filozofinë



4



5

fjalë të vetme kundërvënien publike të disa prej kundërshtarëve të Kadaresë, cila do të ishte ajo fjalë? Të them të drejtën nuk e prisja një pyetje të tillë prej tij, ndaj, për herë të parë në bisedë hezitova të përgjigjem "vetëtimthi". U desh të mendohesha për disa sekonda, sepse në mendje mu sollën disa fjalë që do të ishin të përshtatshme, si xheloz, Shqipëri, mbrojtje, dukje, prijte etj. Por sfida ishte se duhej të përgjigjesha në një fjalë të vetme. Fjala që u dhashe qe: *Injorance*.

Cili ishte reagimi i tyre pas përgjigjes tuaj?

Mesa duket, ata nuk e pritën një përgjigje të tillë. Nuk folën, por reagimet e dukshme të fytyrave të tyre, më dhanë të kuptoj se duhej të bëja shpjegime të mëtejshme. U mundtova ta mbyllja kapitull më shpjegime anësore duke shpjeguar se: dikur shkencëtarët besonin se një objekt gjatë djegies lëshonte një substancë që quhet hlogjiston, që në vizionin tonë dukej si flakët e zjarrit. Mjekët dikur besonin se shtundjet vijnin si humbje e ekuilibrit të humorit (dikja e ngjashme me energjitë emocionale) në gjak. Biologjistët dikur besonin se gjallesat nuk do të ndërpriteshin kurrë nga ekzistenca, dhe se nuk mund të vijnin kurrë gjallesa të tjera në ekzistencë. Gjeologët dikur besonin se kontinentet nuk kanë lëvizur kurrë nga vendi që gjendeshin të pozicionuar. Shumica e njerëzve në botë besonin se dielli sillte rreth tokës dhe se tokja ishte qendra e universit. Por tani ne dimë se këto ide, dikur të pranuar nga shumë njerëz inteligjentë, nuk janë të vërteta. Me këto shpjegime desha të jap përshytyjen se kundërshtarëve të Kadaresë u duhet akoma kohë për ta kuptuar atë dhe rrolin e tij në letërsinë shqipe dhe botërore. Unë shpreh habidjen time se pavarësisht nga origjina e acarimit apo e urrejtjes së disave ndaj tij, shtresa më e thellë e veprimëve të tyre ndaj Kadaresë nuk është asgjë tjetër veçse një moca i përmblytur nga ujërat e zeza të injorancës. Gjithnjë duke lënë të kuptojnë se këto janë gjykimet e mia personale dhe se mund të mos reflektojnë këndvështrimet e të tjerëve kundrejt kësaj çështjeje, shpjegova se, në fakt, lufta kundër Kadaresë nuk kishte të bënte fare me Kadarenë personalisht.

Me siguri përgjigja juaj i shtyu të kërkojnë shpjegime të mëtejshme?
Po. Ata u ndalën veçanërisht të fjalë

jetëshkrimi

Shkrimtar, përkthyes e poet, fitues i disa çmimeve ndërkombëtare

Kush është Gjek Marinaj?

Gjek Marinaj u lind në fshatin Brurt të Malësisë së Madhe, në vitin 1965. U largua nga Shqipëria për arsye politike në vitin 1990 dhe u vendos si azilant politik në SHBA. Në vitin 1994 ai përfundoi studimet në Institutin Mjekësor ASPT në Arlington. Katër vjet më vonë u diplomua në Shkencat e Përgjithshme të kolegjit "Brookhaven" në Dallas. Shkollën e lartë të arteve dhe humanizmit e përfundoi në Universitetin e Dallasis, në Teksas. Ai është autor i dy librave me poezi, tri librave me përkthime dhe i një libri intervistash me individualitet të zgjedhura. Marinaj është gjithashtu botues dhe redaktor aktual i revistës "Pena", revistë letrare e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Aktualisht ai vazhdon studime specializuese pasuniversitare për në degen e Letërsisë Botërore në UTD. Shkrimet me karakter akademik-letrar i janë botuar në disa gazeta dhe revista letrare amerikane. Emri i tij është përkthirë edhe në 4 antologji poetike amerikane: "A Moment in Time" (1995), "A Muse to Follow" (1996), "Best Poems of the



PERSONAZHI
Aktualisht, Marinaj jep mësim lëndët English & Communications si dhe Letërsinë Botërore në "Richard College", në Dallas të Teksasit, ku jeton me bashkëshorten e tij, Dusita

"90" (1999) dhe "Echoes From the Silence" (2003). Po kështu, në vitin 2003, dy poezitë e tij u përkthirë në antologjinë "Un alfabet al poeziei albaneze" në Rumani, përkthyer dhe botuar në rumanisht nga shkrimtari Ardan Kyçyku. Shkrimtari, poeti e përkthyesi Marinaj, gjithashtu deri tani ka fituar disa çmime letrare, ku ndër të tjera mund të përmendim çmimin e parë në poezi (13 tetor, 2006), dhënë nga revista letrare "Sojourn" me rastin e 18-vjetorit të botimit të saj. Librat që ka botuar deri më tani janë: "Mos më ik larg", 1995 (poezi), "Infinit", 2000 (poezi) "Ana tjetër e pasqyrës", 2003 (intervista) "Ora e paqes", 2005, (përkthim dhe poezi nga Rainer Schulte) "Në shpellën e Platonit", 2006 (përkthim dhe poezi nga Frederick Turner) "Poezia Bashkëkohore Amerikane", 2006 (Antologji e poezisë bashkëkohore Amerikane-përkthim). Aktualisht, Marinaj jep mësim lëndët English & Communications si dhe Letërsinë Botërore në "Richard College", në Dallas të Teksasit, ku jeton me bashkëshorten e tij, Dusita.

FOTOT

- 1. Gjek Marinaj, shqiptaro-amerikani që dëshmon për "Shqip"
- 2. Shkrimtari i famshëm Ismail Kadare, Paris 2003
- 3. Kogertina e librit "Ora me tri huazë" e Kadaresë, që studiçhet në tekstet mësimore të Richard College të Dallasis
- 4. Ismail Kadare në një lokal të Parisit
- 5. Gjek Marinaj duke folur pas marrjes së çmimit nga revista letrare "Sojourn", me rastin e 18 vjetorit të botimit të saj
- 6. Pjesëmarrësit e ceremonisë së ndarjes së çmimeve nga revista "Sojourn"
- 7. Redaktori i revistës "Sojourn", duke i dorëzuar çmimin Marinajit

pikës së bisedës. Filozofia e tyre është: "mbrojtja më e mirë është sulmi." Ata ose i kanë kryer vetë, ose janë të instrumentuar nga ata që i kanë kryer vetë ato "krime" për të cilat akuzojnë Kadarenë. Këtyre tip njerëzish "u shkon bark nga goja" kundra Kadaresë, vetëm për të mbajtur krimet e veta në breshërë dhe fjalëve të këqija dhe shpifjeve, duke i bërë parapritë dhe duke ia bërë të frikshme shoqërisë iniciativën e mundshme për t'u futur në mes për të zbuluar të vërtetën. Por, grupi i pestë dhe më i rrezikshmi përbehet nga ata që e sulmojnë Kadarenë për të dëmtuar kombin shqiptar. Ata nuk duan që Kadareja të fitojë çmimin "Nobel", sepse nuk duan që Shqipëria ta fitojë atë. Ata nuk duan që Kadareja të studiohet në koleget dhe universitetet e huaja, sepse edhe tematika, shqetësimet, kultura, dhe jeta e shqiptarëve do të studiohej e vlerësohej. Ata nuk duan që Kadareja të zotërojë vendin e vet në hartën e letërsisë botërore, sepse nuk duan që Shqipëria të zotërojë vendin e vet në hartën e letërsisë botërore...

Cilat janë marrëdhëniet tuaja personale me Kadarenë?

Kryesisht marrëdhënie autor-lexues. Deri tani nuk kam pasur fatin të takohem me të personalisht, por kam biseduar 3-4 herë më të në telefon. I jam mirënjohës që më ka dhënë një intervistë të gjere dhe të sinqerte për librin tim "Ana tjetër e pasqyrës". Por mbi të gjitha i jam mirënjohës për letërsinë e tij, studimin i së ciles ka bërë ndryshime rrethore në drejtimin e jetës time intelektuale.

A e di Kadareja që libri i tij studiomërisht në kolegjin ku juaj mësim?

Nuk jam i sigurt.
Të kthehemi te biseda juaj me profesorët e "Richard College", si përfundoi ajo?

Me mbarimin e bisedës zura tre miq të rinj, të cilët i falënderova për miratimin e futjes së librit "Ura me tri huazë" në programin e kolegjit. Kur u ngritën në këmbë për të dalë, profesoresha Fleming më bëri pyetje e parë: "The se lufta kundër Kadaresë nuk ka të bëjë fare me Kadarenë. Por pate mundësi t'i thuash të gjitha ato që kishin për të thënë në lidhje me perceptimin tënd?" Unë i përgjigja: Cilido shkrimtar shqiptar, po të gëzoje madheshinë e Kadaresë, do të sulmohej me të njëjtat akuzat, nga të njëjtat grupe. Në të njëjtën kohë, i solla ndërmend se kjo nuk është as një dukuri e re, as një fenomen autentik shqiptar. Shtova se të njëjtat fat, afërsisht në të njëjtën moshë që ka Kadareja sot, ka vuajtur edhe Sokrati në vitin 339 para Krishtit, të cilin e akuzuan për korruptionin dhe mëkatin e të rinjve. Gjykata, i kujtova asaj, pat zgjedhur një juri të përbërë nga 501 qytetarë, 281 prej të cilëve e cllasuan faktor dhe e denuan me detyrë edukuesin dhe filozofin e shkretë, dhe asnjë prej tyre, me sa di unë, nuk ka qenë shqiptar.